



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

Tiranë, më 09.08. 2022

**LËNDA: SHTOJCË PËR MODIFIKIMIN E DOKUMENTAVE STANDARDE TË
PROCEDURËS SË KONKURRIMIT PUBLIK**

- 1- Autoriteti Kontraktor, adresa, nr. tel:** Ministria e Kulturës, Rr. “Aleksandër Moisiu”, nr.76, ish-Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, Nr. Tel 04 222 3077
- 2- Emërtimi dhe vendodhja e objektit:**
“Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të Ish-Kinostudios, “Shqipëria e Re”, Tiranë, Faza II”.
Adresa: Rr. “Aleksandër Moisiu”, nr.76, ish-Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë
- 3- Lloji i procedurës së konkurrimit:** Punë
- 4- Objekti i kontratës:** “Parku i Artit, rivitalizimi dhe rikualifikimi i territorit të Ish-Kinostudios, “Shqipëria e Re”, Tiranë, Faza II”
- 5- Fondi limit:** 155,008,461 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e një) lek pa TVSH.

Në zbatim të të Udhëzimit Nr.269, datë 11.08.2020 të Ministrit të Kulturës “Për miratimin e dokumentave standarde të konkurrimit publik për përzgjedhjen e subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve në fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar, “Mbi Veprimet procedurale” Njësia e Hartimit të Dokumentave të Konkurrimit me iniciativën e vet;

VENDOSI:

Modifikimin e Dokumentave Standarde të Procedurës së Konkurrimit Publik, si më poshtë vijon:

Shkronja dh) e kriterëve të përgjithshme për kualifikim ishte:

Subjekti të ketë përvojë të mëparshme në kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse në pasuritë kulturore gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së fondit limit.

Shkronja dh) e kriterëve të përgjithshme për kualifikim bëhet:

Subjekti të ketë përvojë të mëparshme në kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse, të mbikëqyrjes dhe/ose të kolaudimit në pasuritë kulturore gjatë tre viteve të fundit në një vlerë **jo më të madhe se 50 %** e vlerës së fondit limit. Për të vërtetuar këtë kriter, operatori ekonomik, duhet të paraqesë kontrata të ngjashme të lidhura me institucione publike apo edhe me subjekte

private gjatë tre viteve të fundit, të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të kontratës dhe/ose fatura tatimore.

**8. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ishte data: 10.08.2022 ora: 12.00 bëhet data:
15.08.2022 ora: 12.00**

**9. Afati kohor për hapjen e ofertave ishte data: 10.08.2022 ora: 12.30 bëhet data:
15.08.2022 ora: 12.30**

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË KONKURRIMIT: